

Programi i Unionit Evropian "IPA II" për "Kosovën"

Produkti D1.2.1

KORNIZA E MONITORIMIT DHE VLERËSIMIT PËR ZYRËN E KOORDINATORIT NACIONAL PËR ANTI-TRAFIKIM

"Lëvizja Përpara":

Promovimi i efikasitetit dhe efektivitetit më të madh në luftë kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore në Kosovë"



Projekt i Financuar nga BE dhe i menaxhuar nga zyra e BE në Kosovë



Projekt i implementuar nga
Family and Childcare Centre
(KMOP)



Kontrata Nr:
2016/382-826

Korniza për Monitorim dhe Vlerësim për Zyrën e Koordinatorit Nacional për Anti-Trafikim



INSTRUMENTI PËR ASISTENCË PARA PRANIMIT (IPA II)
Vija Buxhetore: BGUE-B2014-22.020101-C1-ELARG DELKOS
Referenca: EuropeAid/150787/DD/ACT/XK

**“LËVIZJA PËRPARA: PROMOVIMI I EFIKASITETIT DHE
EFEKTIVITETIT MË TË MADH NË LUFTËN KUNDËR TRAFIKIMIT
ME QENIE NJERËZORE NË KOSOVË”**

NUMRI I KONTRATËS: 2016/382-826

Produkti D1.2.1

Korniza e Monitorimit dhe Vlerësimit për zyrën e Koordinatorit
Nacional Antitrafikim

Informata të dokumentit

Data e caktuar e dorëzimit	30/10/2017
Data e dorëzimit aktual	30/10/2017
Emri i organizatës dhe kontraktorit Lider për këtë produkt	KMOP
Revizioni	2.0

Niveli i Shpërndarjes

PU	Publik	
PP	I Kufizuar për pjesëmarrësit e programit (përfshirë shërbimet e komisionit)	
RE	I Kufizuar për grupin e specifikuar nga Konzorciumi (përfshirë shërbimet e komisionit)	
CO	Konfidencial, vetëm për anëtarët e konzorciumit (përfshirë shërbimet e komisionit)	X

Lista e autorëve	
Autori	Autori
Blerta Perolli-Shehu	KMOP
Antigona Dajakaj	KMOP
Rishikuesit	
Rishikuesi	Partneri
Vassia Karkantzou	KMOP
Antonia Torrens	KMOP
Gresa Kelmendi	PVPT
Hamijet (Keti) Dedolli	PVPT
Effie Liristi	EPLO
Alexandra Koufouli	EPLO
Verzioni	
Verzioni	Përmbledhja
1.0	Zhvillimi i draft versionit v01
2.0	Zhvillimi i draft versionit v02

Projekti është i financuar me përkrahjen me e Komisionit Evropian.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e autorit, dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si refleksion i pikëpamjeve të Bashkimit Evropian

PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA	4
I. HYRJE	6
II. INFORMATA BURIMORE	7
III. KONCEPTET E MONITORIMIT DHE VLERËSIMIT	8
IV. QASJA E ORIENTUAR NË REZULTATE	8
1.Çka mendojmë me Kornizën e orientuar në rezultate për Monitorim dhe Vlerësim? ...	9
(a) Caktimi i drejtimit	10
(b) Planifikimi i rezultateve të synuara	13
(c) Implementimi i strategjive dhe intervenimeve	14
(d) Monitorimi dhe vlerësimi i implementimit të strategjisë	15
V. PËRDORIMI I QASJES SË ORIENTUAR NË REZULTATE ME STRATEGJINË DHE PLANIN E VEPRIMIT AKTUAL	16
1. Vështrim i strategjisë dhe planit aktual të veprimit.....	16
2. Hapat në të ardhmen dhe rekomandimet.....	17
3. Korniza e M&E për strategjinë aktuale.....	18
Aneksi 1:.....	0
Lista e referimeve	0

LISTA E SHKURTESAVE

Shkurtesa	Domethënia
AT	Anti-Trafikim
KMOP	Qendra për Kujdesin e familjes dhe fëmijëve
M&E	Monitorimi dhe Vlerësimi
EPLO	Organizata Evropiane për Ligjin Publik
PVPT	Qendra për mbrojtjen e Viktimave dhe parandalimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore
ZKNAT	Zyra e Koordinatorit Nacional për Anti-Trafikim
KNAT	Koordinatori Nacional për Anti-Trafikim
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
VT	Viktimat e Trafikimit
MNR	Mekanizmi Nacional i Referimit
PSV	Procedurat Standarde të Veprimit
TQNj	Trafikimi i Qenieve Njerëzore
PESTEL	Analiza Politike, Eknomike, Sociale, Teknologjike, Mjedisore dhe Ligjore
SWOT (FDMK)	Forca, Dobësitë, Mundësitë, Kërcënimet
OECD (OKZHE)	Organizata për Kooperim dhe Zhvillim Ekonomik

I. HYRJE

Ky dokument siguron një mekanizëm për zhvillimin e një Kornize gjithëpërfshirëse të Monitorimit dhe Vlerësimit (M&V) bazuar në qasjen e orientuar drejt rezultateve brenda Zyrës së Koordinatorit Nacional Anti-Trafikim. Kornizë që jo vetëm do të udhëheqë monitorimin e zbatimit të Strategjisë Nationale dhe Planin e Veprimit kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2015-2019, por do të përdoret gjithashtu për zhvillimin dhe monitorimin e strategjisë së ardhshme.

Dokumenti është zhvilluar në kuadër të projektit të financuar nga BE-ja "Lëvizja përpara - Promovimi i efikasitetit dhe efektivitetit më të madh në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore në Kosovë" i implementuar nga Qendra për Kujdesin e Familjes dhe Fëmijëve (KMOP) në bashkëpunim me EPLO (GR) dhe Qendrën për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore (PVPT) nga Kosova (financuar nga Zyra e BE-së në Kosovë). Projekti filloi në Janar 2017 dhe do të zgjasë deri në Janar 2020 me objektiv të përgjithshëm për rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të luftës kundër trafikimit me qenie njerëzore (TQNj) në Kosovë duke rritur aftësinë e institucioneve të Kosovës për të koordinuar dhe zbatuar në mënyrë efektive të gjitha masat kundër -TQNj, në përputhje me praktikën më të mira të rregullave (Acquis) të BE-së dhe prioritetet e përgjithshme të zhvillimit të Kosovës.

Qëllimi i këtij produkti është të zhvillojë një Kornizë të M&V, në bazë të së cilës do të monitorohet rregullisht nga ZKNAT Strategjia e re AT dhe plani përkatës i veprimit. Gjatë fazës fillestare të këtij projekti si dhe përmes konsultimeve të mëtejshme me ZKNAT është konstatuar se nuk ekziston një sistem zyrtar i M&V për monitorimin e Strategjisë dhe vlerësimin e përshtatshmërisë së tij. Për më tepër, gjatë vlerësimit të shpejtë të nevojave u përcaktua se nevojitet një qasje strategjike dhe mekanizma të zhvilluara siç duhet për planifikimin, monitorimin dhe vlerësimin e planeve të veprimit dhe zbatimin e politikave dhe strategjive nacionale kundër trafikimit (AT). Megjithatë ZKNAT ka zhvilluar një qasje strategjike, ka hapësirë për përmirësim kur është fjala te cilësia e objektivave strategjike dhe veprimeve të përcaktuara. Në diskutimet me ZKNAT, u ngritën çështjet lidhur me mënyrën se si identifikojnë objektivat, dhe caktojnë caqet dhe treguesit kur ata zhvillojnë strategjinë dhe planet e veprimit dhe se si ata vazhdojnë me monitorimin dhe vlerësimin. Prandaj, korniza e paraqitur këtu shkon përtej nevojës së menjëhershme për një mjet për të monitoruar strategjinë dhe planin e veprimit aktual, me qëllim që të shërbejë në të mirë të ZKNAT për një kohë të gjatë përtej Strategjisë 2015-2019.

Vlerësimi ynë zbuloi se zyra e KNAT ka nevojë për njohuri dhe aftësi shtesë në zhvillimin dhe planifikimin e strategjisë, si dhe në monitorim dhe vlerësim, për shkak të vështirësive me të cilat ballafaqohet aktualisht në monitorimin e zbatimit të strategjisë dhe mungesën e mjeteve të besueshme për M&V, veçanërisht për vlerësimin periodik të arritjes së objektivave dhe rezultateve. Prandaj, një nga çështjet kyçe të identifikuara gjatë diskutimeve me palët e interesit ishte nevoja për ngritjen e kapaciteteve në zhvillimin dhe menaxhimin e mekanizmave për monitorim dhe vlerësim, si dhe fuqizimin e mekanizmit të ri për M&V. Ky version i kornizës është një dokument i brendshëm që do të udhëzojë për ndihmën në

vendin e punës që ofrohet në ZKNAT lidhur me Monitorimin dhe Vlerësimin. Një version më i shkurtër që do të ndahet me përfituesin, do të pasohet nga një seminar dhe mbështetje në vendin e punës, gjatë së cilës matrica e kornizës logjike për M&E dhe treguesit përkatës do të zhvillohen dhe përcaktohen më tutje me ta në mënyrë që ndjenja e pronësisë të jetë e promovuar në mesin e përfituesve dhe akterëve të tjerë kryesorë. Përkrahja e vazhdueshme do t'i ofrohet KNAT dhe ZKNAT në monitorimin e zbatimit të Strategjisë AT dhe legjislacionit përkatës përmes mentorimit dhe stërvitjes së bërë sipas porosisë për të plotësuar nevojat e personelit të ZKNAT-it të cilët janë përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Strategjisë dhe ndikimin e saj.

II. INFORMATA SHITESË

Lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore është një nga prioritetet kryesore të qeverisë së Kosovës dhe të gjitha përpjekjet e qeverisë së Kosovës ndaj kësaj janë përshkruar në Strategjinë Nacionale Kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore në Kosovë 2015-2019. Strategjia thekson fuqishëm se trafikimi është një shkelje e të drejtave të njeriut dhe një nga format më agresive të krimit të organizuar që minon shoqërinë e Kosovës. Strategjia koordinohet, zbatohet dhe monitorohet nga Autoriteti Nacional kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Autoriteti Nacional Anti-Trafikim është një mekanizëm i themeluar me Ligjin nr. 04/L-218, dhe përbëhet nga të gjitha institucionet e përcaktuara në nenin 6 të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit të Qënieve Njerëzore dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikuara, si dhe institucioneve të tjera përkatëse shtetërore, duke përfshirë përfaqësuesit e ofruesve vendor të shërbimeve, qeveritare dhe organizatat joqeveritare.

Në bazë të Nenit 8 të Ligjit nr. 04/L-218, qeveria emëron Koordinatorin Nacional Anti-Trafikim, i cili kryeson këtë Autoritet Nacional dhe që është gjithashtu Zëvendës Ministër i Punëve të Brendshme. Koordinatori bashkëpunon në mënyrë të vazhdueshme me institucionet e Autoritetit Nacional dhe me autoritetet e tjera të zbatimit të ligjit me qëllim parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e personave të trafikuar. Koordinatori, me mbështetjen e Sekretariatit për Monitorimin dhe Vlerësimin e Strategjive Nacionale, i cili funksionon në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, zhvillon, koordinon dhe monitoron zbatimin e Mekanizmit Nacional të Referimit për të siguruar identifikimin, referimin, ndihmën dhe mbrojtjen e duhur të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, duke përfshirë fëmijët viktimë, dhe për të siguruar se ata do të marrin asistencën adekuate duke mbrojtur të drejtat e tyre njerëzore.

Sekretariati Anti-Trafikim, ashtu si ZKNAT, është përgjegjës për mbledhjen e informative dhe të dhënave nga institucionet e tjera për zbatimin e Strategjisë Nacionale kundër Trafikimit, si dhe analizimin dhe vlerësimin e këtyre informatave. Përgatit raporte analitike për Koordinatorin Nacional i cili monitoron dhe vlerëson punën e aktiviteteve që rrjedhin nga Plani i Veprimit të Strategjisë. Propozon ndryshime dhe përmirësime në sistemin dhe mekanizmat e Strategjisë Nacionale përmes Koordinatorit Nacional dhe e këshillon atë për hapat që duhen ndërmarrë për zbatimin e Strategjisë, inkurajon rritjen e transparencës së veprimtarisë së institucioneve shtetërore të përfshira në

Strategjinë Nacional e kundër Trafikimit, duke bashkëpunuar me institucionet e tjera dhe shoqërinë civile dhe duke ofruar shërbime teknike administrative për Ekipin Ndërinstitucional të Strategjisë.

Aktualisht ZKNAT përbëhet nga gjithsej 4 persona - Koordinatorin Nacional , Ndihmësi i tij, Drejtori i Departamentit të Strategjive dhe Zyrtari i Lartë për Antitrafikim.

Në përputhje me përgjegjësitë e ZKNAT, zyra zhvillon, koordinon dhe monitoron zbatimin e mekanizmit referues Nacional për të siguruar identifikimin, referimin, ndihmën dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit, duke përfshirë viktimat fëmijë, si dhe për të siguruar që ata marrin asistencë adekuate duke ju mbrojtur të drejtat e tyre njerëzore.

Çfarë paraqet ky rezultat, është një kuadër për të mbështetur përgjegjësitë e ZKNAT dhe zbatimin e Strategjisë Nationale nëpërmjet një qasje të orientuar drejt rezultateve të Monitorimit dhe Vlerësimit - një qasje e adoptuar ndërkombëtarisht për planifikimin dhe menaxhimin e zhvillimit që thekson masat ose rezultatet për të siguruar efektivitetin zhvillimor.

III. KONCEPTET E MONITORIMIT DHE VLERËSIMIT

Ndërtimi i një sistemi monitorimi dhe vlerësimi në thelb mbyll ciklin e zhvillimit dhe planifikimit të duhur strategjik. Ajo që zakonisht mungon nga sistemet e qeverisë është komponenti i reagimit në lidhje me rezultatet dhe pasojat e veprimeve qeveritare. Kjo është arsyeja pse ndërtimi i një sistemi të M&V i jep vendimmarrësve një mjet shtesë të menaxhimit.

OECD (2002a) përcakton monitorimin dhe vlerësimin si vijon: Monitorimi është një funksion i vazhdueshëm që përdor grumbullimin sistematik të të dhënave mbi treguesit e specifikuar për të siguruar menaxhmentin dhe akterët kryesorë të një intervenimi të vazhdueshëm zhvillimor me indikacione për shtrirjen e progresit dhe arritjen e objektivave dhe progresin në përdorimin e fondeve të alokuara (faqe 27). Vlerësimi është vlerësim sistematik dhe objektiv i një projekti, programi ose politike të vazhdueshme ose të përfunduar, duke përfshirë hartimin, implementimin dhe rezultatet e tij. Qëllimi është të përcaktojë relevancën dhe përmbushjen e objektivave, efikasitetin e zhvillimit, efektivitetin, ndikimin dhe qëndrueshmërinë. Vlerësimi duhet të ofrojë informacione të besueshme dhe të dobishme, duke mundësuar inkorporimin e mësimave të nxjerra në procesin e vendimmarrjes për të dyja palët, pranuesve dhe donatorëve (fq. 21).

IV. QASJA E ORIENTUAR NË REZULTATE

Qasjet e orientuara drejt rezultateve filluan të zbatohen në fillim të viteve 1990 në përpjekjet për të lëvizur përtej qasjeve strategjike që përqëndrohen kryesisht në të dhëna dhe aktivitete, drejt qasjeve që i japin më shumë vëmendje rezultateve. Kjo përdoret gjerësisht në sektorin publik dhe joqeveritar. Qëllimi i qasjes është që të matë rëndësinë dhe efektivitetin e rezultateve të një strategjie të caktuar, në vend që të fokusohet vetëm në aktivitete dhe rezultate, dmth. ajo që


Ilogaritet nuk është nëse ose sa është lehtësuar arsimi joformal, punësimi etj., por sa viktimat kanë përfituar nga kjo, apo, jo sa shërbime psikologjike i janë ofruar viktimës, por sa është përmirësuar mirëqenia e viktimës.

Menaxhimi në bazë të rezultateve nënkupton një koncept i cili fuqishëm thekson se vizioni i përbashkët, qëllimet e qarta dhe rezultatet e matshme do të na dërgojnë në rezultate më të mira dhe ndikim më të madh. Kjo përfshin procesin e menaxhimit të ndryshimeve që thekson një zhvendosje të fokusit nga inputet, aktivitetet dhe rezultatet në rezultatet dhe ndikimet. Gjithashtu promovon konceptin e "përgjegjësisë për rezultatet".

Arsyetimi i cili mbizotëron për një qasje të orientuar drejt rezultateve është thjesht se sektorët publikë dhe joqeveritarë ekzistojnë për të bërë një ndryshim progresiv dhe pozitiv, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në jetën e njerëzve. Prandaj, organizatat në këto sektore kanë një detyrim që të përpiqen të rrisin kontributin e tyre në qëllimet që u janë caktuar atyre dhe të dëshmojnë se janë duke bërë dallimin që pritet. Në shumë mënyra, kjo nuk ndryshon nga ajo që ndodh në organizatat e sektorit privat, të cilat janë të orientuara drejt rezultateve si në menaxhimin dhe në përgjegjësinë ndaj palëve të interesit. Prandaj, qasja shihet si një aspekt thelbësor i qeverisjes së mirë për të përmirësuar efikasitetin dhe efektivitetin e zhvillimit, transparencën, llogaridhënien dhe vendimmarrjen e informuar. Një sistem i mirë monitorimi dhe vlerësimi duhet të tejkalojë kufijtë institucionalë dhe të sigurojë orientimin e rezultateve në qeverisje dhe zbatim të strategjisë.

1. Çfarë mendojmë me Monitorimin e Orientuar në Rezultate dhe Kornizën e Vlerësimit?

Menaxhimi i orientuar drejt rezultateve është një qasje sistematike për të planifikuar, implementuar, menaxhuar, matur dhe raportuar atë që bëjmë me një fokus të qartë në rezultatet që synojmë të arrijmë dhe sa mirë i arrijmë ato. Me këtë, vëmendja jonë shkon përtej asaj që bëjmë dhe si e bëjmë punën tonë, duke vënë në pahë ndryshimet të cilat janë bërë nga efektet në grupin tonë të synuar. Kjo përfshinë: (a) përcaktimin e drejtimeve se çfarë duam të arrijmë në vitet e ardhshme dhe përcaktimin e vizionit dhe qëllimeve; (b) planifikimin e rezultateve të synuara dhe aktiviteve relevante, dhe radhitjen e burimeve pas tyre; (c) zbatimin e strategjive/ndërhyrjeve që do të kontribuojnë në arritjen e këtyre rezultateve; (d) monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të strategjive, dhe kur është e nevojshme, të bëhen përshtatje për të përmirësuar efikasitetin dhe efektivitetin, si dhe përdorimin e informatave dhe të provave mbi rezultatet aktuale për vendimmarrje, mësim dhe raportim në të gjitha nivelet. Diagrami në vijim prezanton këtë cikël, i cili i nënshtrohet vlerësimeve të vazhdueshme të rezultateve.



(a) Caktimi i drejtimit

Ky hap i parë i ciklit siguron punën analitike nga e cila dalin vizioni, misioni, qëllimet, objektivat dhe strategjitë.

Është thelbësore që procesi të jetë gjithëpërfshirës dhe pjesëmarrës dhe të shprehë opinionet e të gjithë akterëve të përfshirë. Prandaj, është e domosdoshme që para se të vendoset për të zhvilluar një strategji të re, të bëhet një hartë (listë) e palëve të interesit. Identifikimi i hershëm i akterëve relevantë që mund të përfshihen direkt ose indirekt në strategji dhe implementimin e saj mund të kontribuojnë shumë pozitivisht në suksesin e strategjisë. Pasi të identifikohen palët e interesit, bëhet një vlerësim në lidhje me dy dimensionet; interesi kundrejt forcës: cili është interesi i tyre për çështjen dhe cili është niveli i forcës së tyre për të ndikuar në çështje. Kjo ndihmon pozicionimin e secilës palë të interesit në një rrjet koordinativ dhe përcakton rëndësinë dhe relevancën e tyre në strategji.

Në mënyrë që të vendoset drejtimi i duhur dhe relevant drejt arritjes së rezultateve dhe zhvillimit të strategjive, katër pyetje duhet adresuar:

1. Nga kemi ardhur?
2. Ku jemi tani?
3. Ku duam të jemi?
4. Si të arrijmë atje?

Një rishikim i planeve të veprimit dhe strategjive të mëparshme, si dhe sukseset dhe dështimet duhet kryer për të mbledhur informata për adresimin e pyetjes së parë.

Pyetja e dytë fillon me një rishikim të trendeve të jashtme dhe sfidave të brendshme. Në çdo komunitet ka një sërë faktorësh që kontribuojnë në krijimin dhe egzistimin e sjelljeve të më të rrezikuarve. Prandaj, një vlerësim i faktorëve mjedisorë ose strukturorë, faktorëve të komunitetit dhe faktorëve individualë është e nevojshme për të planifikuar një reagim të përshtatshëm. Një analizë e përgjithshme e mjedisit të jashtëm mund të bëhet duke përdorur mjete të tilla si analiza PESTEL. Analiza PESTEL (politike, ekonomike, sociale, teknologjike, ligjore dhe mjedisore) është një mjet për të shqyrtuar dhe vlerësuar faktorët makro-mjedisorë që ndikojnë në zhvillimin dhe menaxhimin e strategjisë sonë. Është pjesë e analizës së jashtme të kryer gjatë përgatitjes së një analize strategjike e cila ofron një pasqyrë të faktorëve të jashtëm që duhet të merren në konsideratë.



Rezultatet e nxjerra nga analiza PESTEL përdoren kur identifikohen faktorët e jashtëm (kërcënimet dhe mundësitë) në analizën SWOT, e cila është një analizë e ndërmarrë për të identifikuar pikat e forta dhe të dobëta të brendshme, si dhe mundësitë dhe kërcënimet e saj të jashtme. Një analizë SWOT përdoret shpesh në fillim ose si pjesë e një ushtrimi të planifikimit strategjik. Ajo përcakton pikat e forta dhe të dobëta të situatës në një fushë të veçantë si dhe ofron një analizë të mundësive dhe kërcënimeve që mund të lindin në zbatimin e masave të planifikuara. Kjo është faza e parë e planifikimit strategjik për të identifikuar problemet dhe për të tërhequr objektivat kryesore të luftimit të TQNJ. Korniza konsiderohet një mbështetje e fuqishme për vendimmarrje, sepse i mundëson

palëve të interesit të zbulojnë mundësitë për sukses që më parë ishin të paartikuluara ose për të nxjerrë në pah kërcënimet para se të bëhen të pakontrollueshme. Një analizë SWOT adreson këto:

- Forca → - Çfarë bëjmë mirë, çfarë dijmë, çfarë na përkrahë në arritjen e rezultateve
- Dobësitë → - Në cilat aspekte nuk kemi sukses, cka na mungon
- Mundësitë → - Cilat janë mundësitë për të ardhmen, cka mund të përdorim
- Kërcnimet → - Çka na kërcnon/mund të jetë rrezik për të ardhmen

Përveç këtyre dy mjeteve, mund të bëhet një vlerësim i nevojave për të përcaktuar se çfarë nevojitet dhe çfarë pritët të arrihet në pozitat e dëshirueshme.

Këto mjete mbështesin identifikimin e problemit, përcaktimin e faktorëve kontribues për problemin, si dhe cilat veprime/intervenime mund të funksionojnë dhe cilat janë hapat prioritarë për arritjen e rezultateve të dëshiruara

		Caktimi i Drejtimit		
Hartimi i akterëve	PESTEL	SWOT	Vlerësimi i nevojave	Analiza tjera
		Vizioni dhe drejtimi strategjik		
		Caktimi i Qëllimeve dhe objektivave		
		Identifikimi i prioriteteve /fushave tematike		
		Zhvillimi i strategjisë		
		Planifikimi		
		Monitorimi dhe Vlerësimi		

Analiza e procesit të përcaktimit të drejtimit në strategjinë e tanishme AT 2015-2019 sugjeron që një grup ekspertësh dhe akterësh u bashkuan për të analizuar rezultatet e strategjisë së mëparshme dhe të dhënat dhe informatat e tjera relevante për vlerësimin e nevojave, megjithatë nuk ka shënime të një procesi formal të vlerësimit të nevojave, duke përfshirë përdorimin e mjeteve që ne sugjerojmë në këtë seksion.

(b) Planifikimi për rezultatet e qëllimit

Plani përcakton rezultatet që strategjia pret të arrijë me kalimin e kohës. Pas mbledhjes së të gjitha të dhënave relevante, hapi tjetër është planifikimi strategjik për rezultatin e synuar dhe aktivitetet relevante dhe radhitja e resurseve pas tyre. Një kornizë e rezultateve strategjike përcakton indikatorët për të matur arritjen e rezultateve të synuara kundër linjave bazë dhe ka përfshirë mjetet e verifikimit dhe supozimet. Korniza më e zakonshme që përdoret për zgjedhjen e indikatorëve është korniza "hyrjet-aktivitetet-arritjet -rezultati-ndikimi". Kjo siguron një mënyrë për të organizuar të dhënat që kërkohen për të monitoruar progresin dhe sugjeron një mënyrë logjike për mbledhjen dhe analizimin e informatave. Kjo fillon me shqyrtimin e inputeve (hyrjeve) të kërkuara (për shembull, burimet) për implementimin e aktiviteteve, vetë aktivitetet (p.sh. këshillimi), dhe pastaj të arriturat e rezultateve (efektet e menjëhershme, si numri i viktimave në strehimore). Arritjet mund të çojnë në rezultate (efektet e ndërmjetme, të tilla si ndryshimi i sjelljes së rrezikut) që nga ana tjetër mund të çojë në ndikim (efektet afatgjata, të tilla si ulja e rrezikut të trafikimit).

Për të qenë më specifik, INPUTET (HYRJET/BURIMET) tregojnë burimet njerëzore, materiale dhe financiare të përdorura për aktivitete; AKTIVITETET tregojnë veprimet e ndërmarra drejt arritjes së objektivit; ARRITJET tregojnë rezultate të menjëhershme, p.sh. produktet dhe shërbimet, të aktiviteteve të përfunduara; REZULTATET përfshijnë efektet afatshkurtra dhe afatmesme të arritjeve të një ndërhyrje (në nivel individual, ai reflektohet në ndryshimet në njohuri, qëndrime, sjellje dhe praktika); dhe së fundi NDIKIMI tregon efektet afatgjata të strategjive/programëve. Ajo gjithashtu i referohet ndikimit më të gjerë në komunitet dhe në shoqëri në përgjithësi.

Këto konstruksione, së bashku me treguesit, objektivat dhe të dhënat bazë, si dhe aktivitetet relevante, si dhe supozimet dhe rreziqet themelore identifikohen për secilën fushë prioritare/ tematike të identifikuar në hapin e parë. Fushat tematike mund të jenë fusha të tilla si: parandalimi, mbrojtja dhe rehabilitimi, ndjekja penale, partneriteti, monitorimi dhe vlerësimi etj. Për shembull mund të jenë si këto në vijim:

Fusha Tematike	Indikator	Aktiviteti	Arritja	Përgjegjësia	Rezultati	Orari
Parandali mi	Numri i vajzave dhe djemëve të rinj të trafikuar deri në fund të vitit 2017 është redukuar për 30%	Trajnimi për këshilltarët dhe punëtorët social në identifikimin e viktimave, përkrahjen psiko- sociale, vlerësimin e rrezikut, menaxhimin e traumave, etj	Punëtorët e kualifikuar të rasteve	XY	Riintegri mi i plotë i VT	M/Viti

Është shumë e rëndësishme të përgatitet buxheti si pjesë përbërëse e planit, për tu siguruar se burime të mjaftueshme janë vënë në dispozicion për zbatimin efektiv dhe arritjen e rezultateve të synuara. Rreziqet dhe masat lehtësuese të rëndësishme për arritjen e rezultateve identifikohen si pjesë e procesit të planifikimit dhe monitorohen dhe menaxhohen gjatë implementimit.

Përshkrimi i Strategjisë aktuale tregon se planifikimi strategjik nuk është i orientuar drejt rezultateve apo i orientuar drejt arritjeve pasi strategjia dhe plani i veprimit përbëjnë kryesisht veprime dhe objektiva që nuk janë lehtësisht të matshme. Rezultatet e pritshme janë definuar si arritje, ndërsa rezultatet dhe ndikimi nuk janë të përshkruara fare. Mungesa e burimeve të përcaktuara qartë, si dhe masat për rreziqet dhe zbutjen e mundshme të tyre, janë gjithashtu një tregues se planifikimi aktualisht nuk ndjek një qasje të orientuar drejt rezultateve, prandaj nuk është e strukturuar në mënyrën për të mbështetur zbatimin e strategjisë.

(c) Implementimi i Strategjive dhe intervenimet

Kjo fazë përfshin kalimin në implementim të planit. Gjëja më e rëndësishme gjatë kësaj faze, sipas kornizës së rezultateve, është shqyrtimi i rregullt dhe monitorimi i implementimit. Informata mbi rezultatet dhe mënyra se si ato arrihen përdoret në mënyrë aktive për të menaxhuar, përshtatur dhe përmirësuar strategjinë dhe veprimet themelore.

Rezultatet nga shqyrtimet e rregullta (tremujore ose gjysmëvjetore) informojnë vendim-marrjen në një proces të vazhdueshëm të planifikimit si strategjik ashtu dhe operativ. Për më tepër, krijohet një

kulturë e të mësuarit, ku grumbullimi, rishikimi dhe analiza e të dhënave bëhet pjesë e rregullt e punës dhe përdoret për të rritur reagimin ndaj nevojave të grupit tonë të synuar.

Në diskutimet me ZKNAT, është konstatuar se mbledhja e rregullt e të dhënave për veprimet e implementuara është pjesë e përgjegjësive të ZKNAT; procesi megjithatë përfundon me mbledhjen e të dhënave dhe përcaktimin e statusit të implementimit të aktivitetit. Megjithatë, të dhënat nuk përdoren për të informuar vendimmarrjen, për të ndryshuar veprimet në përputhje me veprimet korrigjuese ose për të rishikuar procesin e përgjithshëm të strategjisë.

(d) Monitorimi dhe Vlerësimi i implementimit të strategjisë

Monitorimi është më shumë sesa thjesht matja dhe grumbullimi i të dhënave. Ai gjithashtu përfshin interpretimin e të dhënave dhe nxjerrjen e konkluzioneve. Rishikimi i rregullt i brendshëm dhe analiza e rezultateve sigurojnë menaxhim të orientuar drejt rezultateve dhe mësim. Rishikime të tilla gjithashtu reflektojnë se si ne punojmë për të arritur rezultatet, me qëllim përmirësimin e performancës dhe identifikimin e praktikave të mira. Ato informojnë ciklet e reja të planifikimit dhe janë të rëndësishme për drejtimin e strategjisë.

Është hartuar një plan për monitorim dhe vlerësim që përfshin treguesit, si dhe informatat se kush është përgjegjës për mbledhjen e të dhënave dhe kur, cilat mjete të mbledhjes së të dhënave do të përdoren dhe si do të rrjedhin të dhënat përmes organizatës, dmth. cilët janë përfituesit e informatave. Të dhënat sasiore (kuantitative) dhe cilësore (kualitative) mblidhen sistematikisht në lidhje me grupin e shënjestruar dhe akterët e tjerë relevantë. Cilësia e të dhënave kontrollohet rregullisht, si dhe rruajtja, përpunimi dhe transferimi i duhur. Ndërtimi i vazhdueshëm i kapaciteteve të personelit të programit për të siguruar cilësinë e të dhënave është vendimtare.

Vlerësimet bëhen në faza specifike të ciklit, ndryshe nga monitorimi që është një aktivitet i vazhdueshëm. Vlerësimet përbëjnë bazën për llogaridhënie dhe mësim më strategjik.

Vetë-vlerësimi i kryer të paktën një herë në çdo 2 vjet është një praktikë e mirë. Të gjitha grupet kyçe të interesit janë të angazhuara, me fokus në përputhjen me standardet e kualitetit dhe rezultatet afatshkurtra dhe afatmesme. Kjo ushqen proceset e planifikimit të strategjive dhe planeve të veprimit.

Aktualisht, ZKNAT ka mungesë të një plani të M&V, megjithëse strategjia qartë sugjeron se ekziston një gjë e tillë. Prandaj, ky dokument paraqet një kornizë, brenda të cilit ZKNAT do të jetë në gjendje të përcaktojë një plan monitorimi për përdorim në të ardhmen.

V. PËRDORIMI I QASJES SË ORIENTUAR NË REZULTATE ME STRATEGJINË AKTUALE DHE PLANIN E VEPRIMIT

1. Vështrim mbi Strategjinë dhe Planin Aktual të Punës

Siç është përmendur në vende tjera të këtij dokumenti, dhe gjithashtu gjatë Vlerësimit të nevojave të Trajnimit të kryera nga projekti, u bë e qartë se mungesa e zhvillimit strategjik dhe aftësive të planifikimit të veprimit, si dhe mungesa e mjeteve të duhura për planifikimin strategjik dhe monitorimin dhe vlerësimin kanë rezultuar në një Strategji Nacionale e cila nuk ka objektiva dhe veprime të matshme dhe prandaj mungon vendosja e mirë e synimeve dhe treguesve të strukturuar siç duhet.

Strategjia aktuale rrjedh nga prioritetet e përcaktuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës në luftën kundër të gjitha formave të krimit të organizuar. Vizioni i Strategjisë është: *"Një shoqëri ku trafikimi i qenieve njerëzore është pjesë e së kaluarës"* dhe qëllimi dhe misioni kryesor i strategjisë është *koordinimi i veprimeve parandaluese dhe lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore me qëllim të reduktimit të rasteve të trafikimit në minimum në Kosovë dhe koordinimin për ofrimin e shërbimeve cilësore për viktimat e trafikimit me qëllim të kthimit të dinjitetit të tyre dhe parandalimit të ri-trafikimit të tyre*. Strategjia u hartua bazuar në analizat dhe vlerësimin e gjendjes së përgjithshme në Kosovë, si dhe në bazë të vlerësimit gjithëpërfshirës të zbatimit të Strategjisë së mëparshme kundër TQNJ 2011-2014. Aktualja është e ndërtuar rreth katër objektivave strategjike:

1. Avancimi i parandalimit të trafikimit të qenieve njerëzore përmes informimit, ndërgjegjësimit dhe edukimit të shoqërisë në përgjithësi, dhe në veçanti grupeve të cenueshme rreth pasojave të trafikimit dhe përfshirjes në aktivitetet e trafikimit
2. Forcimi i vazhdueshëm i sistemit të identifikimit, mbrojtjes, asistencës dhe riintegritimit të viktimave të trafikimit përmes programeve të qëndrueshme të përfshirjes sociale
3. Ndjekja penale efektive e rasteve të trafikimit me qenie njerëzore duke rritur efikasitetin e mekanizmave për zbulimin dhe ndjekjen penale të trafikantëve
4. Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtarë dhe lokal për një partneritet të fuqizuar ndaj trafikimit të qenieve njerëzore

Një vështrim i thjeshtë në lidhjen midis objektivave strategjike dhe misionit të Strategjisë tregon një mospërputhje, pasi deklarata e misionit sillet kryesisht rreth koordinimit të veprimeve, të cilat nuk janë përmendur në asnjë nga tre objektivat e parë. Për syrin e lirë, duket sikur vetëm e fundit nga katër objektivat në të vërtetë kontribuon në misionin e strategjisë.

E njëjta gjë mund të vërehet edhe midis objektivave strategjike dhe objektivave specifike që vijojnë. Derisa objektivi i parë strategjik ka të bëjë kryesisht me rritjen e ndërgjegjësimit, disa nga objektivat specifike të saj adresojnë përfshirjen në sistemin arsimor të grupeve të rrezikuara, duke lëvizur përtej ngritjes së vetëdijes në ofrimin e shërbimeve të drejtpërdrejta.

Për më tepër, Strategjia nuk parasheh një sistem konkret monitorimi dhe vlerësimi megjithëse një sistem përmendet shkurtimisht si një sistem i bazuar në ndikime, por nuk ekziston asnjë provë për zbatimin e tij. Sipas Strategjisë, ministrinë pjesëmarrëse në grupin e punës janë përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin e aktiviteteve si institucione bartëse. Këto institucione raportojnë në baza tremujore tek Koordinatorin Nacional, ndërsa Ministria e Punëve të Brendshme si bartës dhe në cilësinë e Koordinatorit Nacional të Anti-Trafikimit ka në strukturën e vet organizative Sekretariatit kundër Trafikimit i cili ka për detyrë monitorimin dhe vlerësimin e strategjisë. Zyra e Koordinatorit Nacional Anti-Trafikim në fund të çdo viti përgatit një raport mbi shkallën e realizimit të objektivave dhe aktiviteteve të cilën e publikon dhe e bën të njohur për të gjithë akterët qeveritarë dhe joqeveritarë.

Duke kaluar prej Strategjisë në Planin e Veprimit, vetë plani nuk përfshin rezultatet dhe ndikimin e Strategjisë, megjithëse Strategjia përmend sistemin e monitorimit dhe vlerësimin të ndikimit. Veprimet janë vendosur pa përcaktuar "si", në kuptimin se si do të kryhet ose sigurohet ky veprim. Duke kaluar nëpër indikator (tregues), shumica e tyre janë të paqarta dhe jo të matshme, dhe më e rëndësishmja është se u mungojnë synimet që pritet të arrihen (p.sh numrat, përqindjet, etj.). Afatet kohore nuk janë përcaktuar në përputhje me veprimet (p.sh. aktivitetet 1.1.2 Nisja e një analize të gjendjes së fëmijëve në lëvizje në Kosovë dhe 1.1.3 Publikimi i një hulumtimi transnacional mbi fëmijët në lëvizje ndërmjet Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë janë vendosur në një afat kohor prej 2 vitesh edhe pse formulimi i veprimeve sugjeron se ato janë ngjarje të cilat ndodhin njëherë). Burimet gjithashtu janë të përcaktuara qartë.

Kjo në asnjë mënyrë nuk sugjeron që kjo është një strategji e keqe sepse ka një plan veprimi të definuar keq. Kjo nënkupton vetëm se është e vështirë të monitorohet dhe të vlerësohet. Mungesa e një kornize logjike që duhet të ndiqet, na sjell në një pikë që të kemi një plan veprimi që nuk është i matshëm, veçanërisht në aspektin e rezultateve dhe ndikimit të arritur. Shfaqja e rezultateve të suksesshme dëshmon të jetë e vështirë kur dikush ballafaqohet me plane të ngjashme të veprimit. Veprimet nuk janë të matshme, sepse nuk është parashikuar një vijë bazë (vija fillestare) dhe nuk janë përcaktuar indikatorët dhe shënjestra (synimi), prandaj progresi nuk është i matshëm.

2. Hapat e ardhshëm dhe rekomandimet

Vlerësimi i Nevojave të Trajnimit dhe ky Produkt kanë identifikuar disa çështje që kanë nevojë për përmirësim në funksionimin e ZKNAT-it, kryesorja duke qenë ngritja e kapaciteteve të KNAT/ZKNAT (dhe në përputhje me atë të akterëve të tjerë) në planifikimin strategjik, monitorimin dhe vlerësimin si dhe metodologjitë dhe mjetet për mbledhjen e të dhënave, në mënyrë që të planifikojnë siç duhet dhe të jenë në gjendje të monitorojë punën e përgjithshme të Autoritetit Antitrafikim/palëve të interesit dhe të masin progresin duke përdorur treguesit e deklaruar në aktivitetet e planifikuara të Planit të Veprimit 2015 - 2019 dhe më tutje.

Përsa i përket implementimit të Kornizës së propozuar të Monitorimit dhe Vlerësimit me strategjinë dhe planin e veprimit aktual, nevojitet një Rishikim Afatmesëm i Planit të Veprimit për të përcaktuar që këto veprime janë ende relevante për arritjen e objektivave të Strategjisë dhe rrjedhimisht edhe të misionit të saj .

Një rishikim afatmesëm së bashku me të gjitha palët relevante të interesit të mbledhur së bashku për të hedhur një vështrim të dytë në objektivat specifike të vendosura pothuajse tre vjet më parë dhe në përputhje me zhvillimet aktuale do të mund të përmirësonte disa nga këto objektiva specifike për t'i ri-orientuar ato në qëllimin dhe misionin e përgjithshëm, si dhe të hartohen veprime korrigjuese ndaj veprimeve që janë të vështira për t'u matur, janë bërë të pavlefshme ose tashmë janë arritur.

Gjatë këtij procesi, indikatorët (treguesit) mund të ri-definohen dhe ndoshta të arriturat dhe rezultatet të dizajnohen për ta bërë planin e veprimit më të orientuar drejt rezultateve dhe më të lehtë për t'u monitoruar, por më e rëndësishmja për ta afruar atë më pranë arritjes së objektivave të strategjisë. Secili indikatorë mund të 'pajiset' me një masë dhe mjet specifik për grumbullimin e të dhënave lidhur me atë se sa është kompletuar me sukses veprimi.

Ndërkohë, korniza përdoret për mbledhjen e të dhënave dhe analizimin e tyre në një qasje të bazuar në rezultate. Ka ende një sasi të madhe të të dhënave të mbledhura nga Autoriteti Nacional , por për aq kohë sa ato grumbullohen vetëm për qëllime raportimi dhe jo për qëllime planifikimi, atëherë kjo i bën të dhënat të tepërta shumë shpejt.

Një kornizë e bazuar në rezultate e paraqitur në këtë produkt lejon që autoriteti qeverisës të rishikojë në mënyrë të vazhdueshme të dhënat e mbledhura dhe të përdorë rezultatet e arritura për të planifikuar dhe përsosur/ri-definuar veprimet dhe indikatorët që vijnë më pas, për sa kohë që veprimet vazhdojnë të kontribuojnë në objektivat e përgjithshme e të miratuara të Strategjisë Nationale. Prandaj, me miratimin e një kornize të tillë për ZKNAT, korniza mund të jetë e përdorshme menjëherë dhe nuk ka nevojë të presë që të hartohet Strategjia e re.

3. Korniza e M&E për Strategjinë aktuale

Sa i përket monitorimit dhe vlerësimit për strategjinë aktuale, më poshtë do të paraqesim një tabelë që shërben si mjet monitorimi për çdo veprim dhe aktivitet të paraparë me Planin aktual të Veprimit. Bazuar në aktivitetet aktuale dhe rezultatet e pritura, ne kemi bërë një përpjekje për të identifikuar indikatorët që mund të jenë objektivist të matshëm dhe ku është e mundur, të përcaktohet synimi për monitorimin e objektivit. Natyrisht, për të treguar dhe dokumentuar arritjet dhe rezultatet e strategjisë, është shumë e dobishme që të ketë të dhëna bazë për secilin aktivitet, të cilat në planin aktual të veprimit mungojnë.

Plani i paraqitur më poshtë është një mjet pune. Projekti propozon që një seri punëtorish dhe/ose sesione “kolegë-me -kolegë” (peer-to-peer) të organizohen me ZKNAT për të kaluar nëpër kornizën si dhe mjete, duke shpjeguar qëllimin e secilës pjesë dhe mënyrën se si mund të operacionalizohen. Punëtoritë do të ishin të dobishme për të përcaktuar më tej indikatorët dhe aspektet e tjera që përfitojnë nga procesi i monitorimit të zbatimit të strategjisë, por edhe krijimi i kornizës së propozuar. Prandaj, tabela e mëposhtme mund të përjetojë ndryshime, të paraqitura gjatë punës së kryer në punëtori/ sesionet “kolegë-me-kolegë”. (shpjegim: “peer to peer” ose “kolegë-me-kolegë” është metodë e të mësuarit nga përvoja e personave të të njëjtës fushë).

<p>MISIONI I STRATEGJISË</p> <p><i>Koordinimi i veprimeve parandaluese dhe lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore në mënyrë që të minimizohen rastet e trafikimit në Kosovë, si dhe koordinimi për ofrimin e shërbimeve cilësore për viktimat e trafikimit me qëllim kthimin e dinjitetit të tyre dhe parandalimin e trafikimit të tyre</i></p>	<p>Aktiviteti</p> <p><i>Veprimi i Identifikuar për të arritur Objektivin</i></p>	<p>Rezultati i Pritur</p> <p><i>Rezultati fillestarë dhe final i cili pritet të arrihet</i></p>	<p>Të dhënat fillestare</p> <p><i>Indikatori është më i besueshëm nëse kemi informatat fillestare për të ndjekur progresin</i></p>	<p>Indikatorët Objektivist të verifikueshëm</p> <p><i>Indikatorët janë mënyra kualitative dhe kuantitative për të gjykuar nëse rezultatet, objektivat dhe qëllimi është arritur. Aty ku është e mundur këshillohet përfshirja e caqeve</i></p>	<p>Statusi i aktivitetit :</p> <p><i>1. Nuk ka filluar 2. Në vazhdim 3. Ka filluar 4. I Kompletuar</i></p>	<p>Frekuenca e mbledhjes së të dhënave</p> <p><i>1. Mujore 2. Dy-mujore 3. Tre-mujore 4. Gjysmë-viti 5. Vjetor</i></p>	<p>Mjetet e Verifikimit</p> <p><i>Ato identifikojnë burimet prej nga informatat për verifikim mund të mblidhen.</i></p>	<p>Personi përgjegjës në ZKNAT</p> <p><i>Është me rëndësi të identifikohet personi në ZKNAT përgjegjës për të mbledhur informata nga burime relevante (institucione relevante)</i></p>	<p>Rishikimi</p> <p><i>Në drejtim të mirë -1</i></p> <p><i>Vështirësi janë shfaqur por mund të trajtohen - 2</i></p> <p><i>Po kalohet në vështirësi, nevojitet revizioni - 3</i></p>		<p>Komentet dhe rekomandimet</p> <p><i>Komentet dhe rekomandimet lidhur me atë se pse është vlerësuar me 1, 2 apo 3. Për më shumë, cdo rekomandim i mundur apo veprim korrektues nëse është vlerësuar me 2 apo 3</i></p>
<p>Objektiva strategjike 1</p> <p><i>Avancimi i parandalimit të trafikimit të qenieve njerëzore nëpërmjet informimit, ndërgjegjësimin dhe edukimit të shoqërisë në përgjithësi, dhe në veçanti grupeve të cenushme rreth pasojave të trafikimit dhe përfshirjes në aktivitetet e trafikimit</i></p>											
<p>Objektiva strategjike 1.1</p> <p>OS 1.1: Ngritja e vetëdijes (ndërgjegjësimi), edukimi dhe informimi mbi çështjet e përgjithshme të trafikimit me qenie njerëzore, përfshirë sanksionet ligjore;</p>	<p>A1.1.1</p> <p>Zhvillimi i analizave dhe vlerësimeve të tendencave të trafikimit dhe nivelit të ndërgjegjësimin të qytetarëve lidhur me këtë fenomen</p> <p>A1.1.2</p> <p>Nisja e një analize të situatës së fëmijëve në lëvizje në Kosovë (duke përfshirë</p>	<p>Analizat e bëra dhe të finalizuara</p> <p>Rishikimi dhe përmbledhja e hulumtimeve të bëra gjatë 2014 mbi nivelin e njohurive të qytetarëve</p> <p>Publikimi i analizës dhe prezantimi i rekomandimeve</p>	<p><i>(të kompletohet nga ZKNAT)</i></p> <p><i>(të kompletohet nga ZKNAT)</i></p>	<p>Të dhënat dhe vlerësimi përkatës gjenerohen dhe shpërndahen te aktorët në baza kohore # i raporteve të shtypura dhe të shpërndara</p> <p>Të dhënat dhe vlerësimi përkatës gjenerohen dhe shpërndahen te</p>	<p><i>(të kompletohet gjatë rishikimit)</i></p> <p><i>(të kompletohet gjatë rishikimit)</i></p>	<p><i>(të definohet nga ZKNAT)</i></p> <p><i>(të definohet nga ZKNAT)</i></p>	<p>Analizat në dispozicion Informatat e shpërndara për palët</p> <p>Analizat në dispozicion Informatat e shpërndara për palët</p> <p>Fakte të ngjarjeve të mbajtura për lansimin e publikimit</p>	<p><i>(të caktohet nga ZKNAT)</i></p> <p><i>(të caktohet nga ZKNAT)</i></p>			

	fëmijët e trafikuar ose fëmijët në rrezik trafikimi			aktorët në baza kohore # i raporteve të publikuara dhe të shpërndara			Lista e pjesëmarrësve në ngjarje				
A1.1.3	Publikimi i një hulumtimi ndërkombëtar mbi fëmijët në lëvizje ndërmjet Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë (përfshirë fëmijët e trafikuar ose fëmijët në rrezik trafikimi).	Publikimi i hulumtimit transnacional Komuniteti dhe grupet e cenuara të vetëdijshëm dhe informuar mbi trafikimin	<i>(të kompletohet nga ZKNAT)</i> <i>(të kompletohet nga ZKNAT)</i>	Analizat relevante të mbajtura dhe të dhënat e shpërndara te palët relevante në baza kohore # i raporteve të publikuara dhe të shpërndara	<i>(të kompletohet gjatë rishikimit)</i>	<i>(të definohet nga ZKNAT)</i>	Fakte të ngjarjeve të mbajtura për lansimin e publikimit Lista e pjesëmarrësve në ngjarje	<i>(të caktohet nga ZKNAT)</i>			
A1.1.4	Organizimi i aktiviteteve educative dhe për ngritjen e vetëdijes me fokus të vecant në komunitete/ regjione / grupe të cenuara për trafikim	Prindërit, kujdestarët ligjor janë të vetëdijshëm mbi rrezikun e shfrytëzimit të pakontrolluar të internetit, rrjeteve sociale dhe TV	<i>(të kompletohet nga ZKNAT)</i>	% e komuniteteve të targetuara të cilat janë të informuara për trafikimin Nr. dhe lloji i aktiviteteve të zbatuara % e prindërve të targetuar / kujdestarët ligjor janë të	<i>(të kompletohet gjatë rishikimit)</i>	<i>(të definohet nga ZKNAT)</i>	Minutat e takimeve / aktiviteteve të mbajtura Lista e pjesëmarrësve në ngjarje Regjistrat e vlerësimit të aktiviteteve Përmbajtja e informatave të shpërndara Minutat e takimeve / aktiviteteve të mbajtura	<i>(të caktohet nga ZKNAT)</i> <i>(të caktohet nga ZKNAT)</i>			

	<p>A1.1.5 Organizimi i ngritjes së vetëdijes së prindërve / kujdestarëve ligjor për mbikqyrjen prindërore të përdorimit të internetit, rrjeteve sociale dhe TV nga fëmijët</p> <p>A1.1.6 Zhvillimi i aktiviteteve për ngritjen e vetëdijes së mësuesve, nxënësve dhe studentëve.</p>	<p>Mësuesit, nxënësit dhe studentët janë të informuar lidhur me fenomenin e trafikimit të qenieve njerëzore</p> <p>1. Numër më i madh i të rinjve të vetëdijshëm për rrezikun e trafikimit</p> <p>2. Redukimi i numrit të rinjve të trafikuar për arsye të vetëdijimit për këtë fenomen të rrezkshëm</p> <p>Vetëdijimi i të gjitha palëve dhe grupeve të prekura lidhur me trafikimin</p>	<p><i>(të kompletohet nga ZKNAT)</i></p> <p><i>Është e rëndësishë së veçant këtu të kemi informata fillestare nëse rezultati i specifikuar është "të ngrisë numrin e të rinjve të vetëdijuar për rrezikun e trafikimit" dhe "të redukohet numri i të rinjve të trafikuar"</i></p> <p><i>Të dhënat fillestare duhet të masin këtë ngritje, respektivisht redukim .</i></p> <p><i>(të kompletohet nga ZKNAT)</i></p>	<p>vetëdijshëm për përdorim të internetit, rrjetet sociale dhe TV</p> <p>Nr. dhe lloji i aktiviteteve të zbatuara</p> <p>% e mësuesve, studentëve dhe nxënësve, të informuar lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore</p> <p>Nr. dhe lloji i aktiviteteve të organizuara</p> <p>% i të rinjve të vetëdijuar për rrezikun e trafikimit</p> <p>% e numrit të redukuar të rinjve të trafikuar si rezultat i vetëdijimit</p> <p>% e njerëzve dhe institucioneve të arritura</p> <p>Nr. dhe lloji i aktiviteteve të organizuara</p>	<p><i>(të kompletohet gjatë rishikimit)</i></p> <p><i>(të kompletohet gjatë rishikimit)</i></p>	<p><i>(të definohet nga ZKNAT)</i></p> <p><i>(të definohet nga ZKNAT)</i></p>	<p>Lista e pjesëmarrësve në ngjarje</p> <p>Regjistrat e vlerësimit të aktiviteteve</p> <p>Përmbajtja e informatave të shpërndara</p> <p>Minutat e takimit / aktivitetet e mbajtura</p> <p>Lista e pjesëmarrësve në ngjarje</p> <p>Regjistrat e vlerësimit të aktiviteteve</p> <p>Raportet e të rinjve (nga intervistat / pyetësorët)</p> <p>Të dhëna për Nr. e të rinjve të trafikuar (e nevojshme për krahasim)</p> <p>Raportet për shifrat e sakta dhe buxheti i</p>	<p><i>(të caktohet nga ZKNAT)</i></p> <p><i>(të caktohet nga ZKNAT)</i></p> <p><i>(të caktohet nga ZKNAT)</i></p>			
--	--	---	--	--	---	---	--	---	--	--	--

